



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.397, datë 17.12.2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. **Znj. Pranvera Gruda**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. **Znj. Pranvera Gruda**, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, nga data 19.12.2021 - 18.03.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim **Znj. Pranvera Gruda**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
MOISI DUDA

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

